

NË GJYKATËN THEMELORE TË PEJËS

Lënda Numër P.nr.86/13

Datë 14/06/2013

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jete i formës së prere dhe munde të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore e Pejës, me trupin gjykues të shqyrtimit gjyqësor të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it, Jonathan Welford-Carroll, si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it Cornelia Peeck dhe gjyqtari i Kosovës Nushe Kuka-Mekaj, si anëtarë të trupit gjykues, dhe proces-mbajtësja Christine Sengl, në lëndën penale kundër:

A.R.,

I akuzuar bashkë me të bashkë-akuzuarin K.P. me Aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (këtej e tutje "PSRK") PPS. nr. 7/2011, datë 23/07/2012, të ngritur në Qarkun e Pejës më 23/07/2012, dhe pjesërisht të konfirmuar me aktvendim të gjyqtarit konfirmues të EULEX-it më datë 20/09/2012, me veprën penale të *shpërdorimi të pozitës dhe autoritetit zyrtar, e kryer në bashkëkryerje*, në shkelje të neneve 23 dhe 339, paragrafët 1 dhe 3, të Kodit Penal të Kosovës ("KPK"),

pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më 29 dhe 30/01, 4/02, 10/04 dhe 10/06 2013, në të cilin A.R. u paraqit për PSRK-në, B.T. u paraqit për të pandehurin A.R., dhe palët e dëmtuara Z.M., B.E., X.H., X.K., N.A. dhe Shoqata e Sigurimeve e Kosovës – Njësia e Sigurimit të Detyrueshëm, të cilët ishin ose të pranishëm, ose u thirrën për të qenë të pranishëm, dhe në të cilën i pandehuri A.R. ishte i pranishëm gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, dhe pas ndarjes së procedurës kundër K.P. me aktvendimin e datës 31/01/2013 në vijim të pranimit të fajësisë nga ana e tij gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 29/01/2013, pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 10 dhe 14/06 2013, më 14/06/2013 shpalli publikisht këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri **A.R.**, me shënimet personale si më lart, është

FAJTOR

Për shpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar, vepër e kryer në bashkëkryerje me K.P., në shkelje të Nenit 3 paragrafi 2, Neneve 31 dhe 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ("KPRK"), sepse i pandehuri A.R. mori pjesë në një procedurë të paligjshme që shkoi kundër interesave të Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës – Njësia e Sigurimit të Detyrueshëm në Prishtinë interesat e së cilës ai paguhej të përfaqësonte, dhe i shkaktoi kësaj kompanie një humbje prej €71,257.40.

* * *

PRANDAJ, për shkak të sa më lart, gjykata cakton këtë dënim:

për veprën penale të *shpërdorimit të pozitës zyrtare*, e kryer në bashkëkryerje, i pandehuri A.R. dënohet me tetëmbëdhjetë (18) muaj burgim.

Në bazë të Nenit 3 paragrafi 2 të KPRK-së dhe Neneve 82 dhe 83 të KPK-së, i pandehuri, A.R. urdhërohet të paguajë shumën e parave që përputhet me përfitimin pasuror prej €71,257.40. I pandehuri, A.R. dhe i bashkakuzuari me të, K.P., detyrohen ta paguajnë këtë shumë bashkërisht dhe veç e veç.

I pandehuri A.R. do të mbulojë shpenzimet e procedurës penale, të vlerësuara në shumën e 500 eurove, bashkë me paushallin e vlerësuar në shumën e 200 eurove.

Palët e dëmtuara mund të ngrenë padi për dëmshpërblim përmes gjykatave civile.

ARSYETIM

HYRJE DHE FORMALITETE

1. Kompetenca gjeografike

1.1. Sipas Aktakuzës, veprat penale u kryen brenda juridiksionit të ish Gjykatës së Qarkut të Pejës. Palët nuk paraqitën asnjë vërejtje në fillim të shqyrtimit gjyqësor lidhur me juridiksionin e kësaj Gjykate.

2. Juridiksioni dhe ligji i zbatueshëm

2.1. Sipas Nenit 23 (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ("KPPK"), gjykatat e qarkut kanë juridiksion për të gjykuar në shkallë të parë veprat penale të dënueshme me burgim prej të paktën pesë vjet, ose ato vepra të dënueshme me burgim afatgjatë.

2.2. Në lëndën në fjalë, të pandehurit K.P. dhe A.R. u akuzuan me vepra që përfshinin shpërdorim të pozitës zyrtare, në shkelje të Nenit 339 paragrafi 3 të KPK-së, vepër e dënueshme me një (1) deri në tetë (8) vite burgim.

2.3. Neni 3 (2) i KPRK-së parashikon që, në rast të ndryshimit të ligjit të zbatueshëm në një lëndë të caktuar para vendimit të formës së prerë, do të zbatohet ligji më i favorshëm për kryerësin.

2.4. Në seancën e saj të datës 07/01/2013, Gjykata Supreme e Kosovës shqiptoi një Opinion Ligjor¹ në të cilin ajo deklaroi se në të gjitha procedurat penale ku shqyrtimi gjyqësor ka filluar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale, do të zbatohet Kodi i vjetër i Procedurës Penale. Ky pozicion u konfirmua edhe në Ndryshimin e Opinionit² më datë 23/01/2013.

3. Kompetenca e trupit gjykues

3.1. Kjo lëndë u ndoq nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (“PSRK”). Në bazë të Nenit 3.1 të Ligjit për Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Ndarjen e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it (Ligji nr. 03/L053), gjyqtarët e EULEX-it të cilëve u caktohen procedura penale, do të kenë juridiksion dhe kompetenca për çdo vepër të hetuar dhe të ndjekur nga PSRK. Nisur nga kjo, kësisoj, trupi gjykues i shqyrtimit gjyqësor i Gjykatës së Qarkut të Pejës u përbë me korrektësi nga një trup gjykues i përzierë i përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar i Kosovës, në pajtim me Nenin 4.7 të Ligjit për Juridiksionin. Palët nuk paraqitën asnjë vërejtje në fillim të shqyrtimit gjyqësor lidhur me përbërjen e trupit gjykues.

4. Në datat e mëposhtme u dëgjuan këto dëshmi dhe prova:

4.1. 29/01/2013

- 4.1.1. Hapja e shqyrtimit gjyqësor dhe njohja me Aktakuzën
- 4.1.2. Vetë-deklarimi i fajësisë nga ana e K.P.
- 4.1.3. Dëshmia e B.E.

4.2. 30/01/2013

- 4.2.1. Dëshmia e Z.M.
- 4.2.2. Dëshmia e A.B.

4.3. 04/02/2013

- 4.3.1. Marrëveshja që deklaratat e dëshmitarëve të përfshihen në proces-verbal³
- 4.3.2. Marrëveshja që provat shkresore/materiale të përfshihen në proces-verbal
- 4.3.3. Vendimi për të shtyrë dorëzimin e ekspertizës së dorëshkrimit lidhur me nënshkrimet e pretenduara të Z.M. dhe A.R..

4.4. 10/04/2013

- 4.4.1. Dëshmia e ekspertit të grafologjisë, z. H.K.⁴
- 4.4.2. Dëshmia e A.R.

5. Lista e të gjitha provave materiale

¹ 93/2013

² 56/2013

³ B.E. (03/03/11), Z.E. (04/02/2011), S.A. (01/03/2011), K.P. (04 & 24/08/11), A.R. (14/03/2011), X.H. (22/02/2011), N.A. (22/01/2011), X.K. (23/01/2012).

⁴ Bashkëngjitur Proces-verbalit të Seancës së Shqyrtimit Gjyqësor të datës 10/04/2013, Shkresat e Lëndës, Vëllimi II në ndarësen A

5.1. Kjo ka të bëjë me të gjitha Eksponatet e ndodhura në Dosjen e Provave I, bashkë me të gjitha eksponatet e tjera të paraqitura ose të nxjerra gjatë shqyrtimit gjyqësor. Këto përcaktohen në Shtojcat A, B dhe C më poshtë.

6. Aktvendimet Ligjore

6.1. Aktvendimi për çështjen e parashkrimit.⁵

6.2. Refuzimi për ta lejuar K.P. të thirret si dëshmitar bashkëpunues.⁶

6.3. E drejta e prokurorit për të marrë në pyetje A.R. lidhur me deklaratën e tij të dhënë më 14/03/2011 pa praninë e një mbrojtësi.⁷

PËRMBLEDHJE E PROVAVE

7. B.E.

7.1. Proces-verbal i dëgjimit para Prokurorit më 3 mars 2012

7.2. Seanca dëgjimore e shqyrtimit gjyqësor më 29/01/2013

8. Dëshmia përkatëse e B.E. mund të përmbledhet si më poshtë:

8.1. Në vitin 2003, B.E. ishte duke ngarë një automjet, kur atë e zuri gjymi mbi timon dhe, për shkak të kësaj, shkaktoi një aksident rrugor ku ai dhe katër udhëtarët e tij pësuan shkak të ndryshme lëndimesh trupore. Lëndimet e B.E. ishin të mëdha. Atë e shtruan në spital, ishte në koma për një javë dhe iu nënshtrua ndërhyrjeve të mëdha kirurgjikale në kokë.⁸

8.2. B.E. deklaroi se N.A. pësoi lëndim në kokë dhe në shtyllën kurrizore. Ai deklaroi se as X.K., as X.H. nuk pësuan ndonjë lëndim të madh. B.E. nuk deklaroi asgjë nga këto lidhur me B.A..⁹

8.3. Ndërkohë që ishte në spital, B.E. mori një ftesë nga Gjykata Komunale e Klinës, nga K.P.. Në seancë morën pjesë të pesë të pranishmit në veturë. K.P. u tha atyre se ata kishin një padi për dëmshpërblim. B.E. nënshkroi për të ngritur padi. Ai beson se të tjerët nënshkruan për të deklaruar se ata nuk donin të ngrinin padi. K.P. i tha B.E. se me këtë çështje do të merrej ai. K.P. i kërkoi B.E. të dorëzonte dokumentacionin mjekësor. K.P. i kërkoi B.E. të nënshkruajë një letër të zbrazët. K.P. i tha gjithashtu B.E. se tarifat e tij për sigurimin e dëmshpërblimit do të ishin 15% të shumës së përgjithshme. Disa muaj më vonë, B.E. kontaktoi me K.P. i cili i tha atij se kishte siguruar një dëmshpërblim në shumën ose 14,200 ose 14,300 euro (B.E. nuk e mbante mend me saktësi). K.P. i dha B.E. 10,000 euro në total dhe përsëri i kërkoi atij të nënshkruajë një letër të zbrazët. Pastaj K.P. i tha B.E. se ai mund të siguronte edhe një shumë tjetër prej

⁵ Shih arsyetimin e hollësishëm të parashtruar në faqet 5 dhe 6 të Proces-verbalit të Seancës së Shqyrtimit Gjyqësor të datës 29/01/2013.

⁶ Shih arsyetimin e hollësishëm të parashtruar në faqet 4 dhe 5 të Proces-verbalit të Seancës së Shqyrtimit Gjyqësor të datës 10/04/2013.

⁷ Shih arsyetimin e hollësishëm të parashtruar në faqet 19 dhe 20 të Proces-verbalit të Seancës së Shqyrtimit Gjyqësor të datës 10/04/2013.

⁸ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 29 janar 2013, f. 14-15

⁹ Marrja në Pyetje nga Prokurori, datë 03/03/2011; Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 29 janar 2013, f. 15

13,000 eurosh për periudhën që ai ishte i paaftë për të punuar. Gjithsej, B.E. mori nga K.P. dy shuma parash, në ose rreth viteve 2004 dhe 2005.¹⁰ Pastaj Dëshmitari tha se K.P. i kishte thënë atij që siguruesit kishin paguar 14,300 euro, nga të cilat K.P. e pagoi atë afërsisht 10,000 euro në vitin 2004, dhe se K.P. i tha dëshmitarit se siguruesit kishin paguar edhe shumën tjetër prej 13,300 eurosh, nga e cila K.P. i pagoi dëshmitarit afërsisht 11,000 euro në vitin 2005. Lidhur me të gjitha pagesat, B.E. deklaroi se ai nuk pa kurrë ndonjë dokument shkresor nga Asistenca IIC.¹¹

8.4. Për rrjedhojë, nisur nga këto kuptohet se dëshmitari nuk kishte dijeni për këto dokumente:

8.4.1. Formulari ICC i Daljes nga Spitali, referenca B-281-03-GD, datë 03/02/2004, për B.E. në shumën e 15,400 eurove¹²

8.4.2. Proces-verbali i GJK të Klinës, C nr 916/2004, datë 14/06/2005, që i jepte N.A. shumën e 13,421.30 eurove¹³

8.4.3. Aktvendimi i GJK të Klinës, C nr 916/2004, datë 14/06/2005, që i jepte B.E. shumën e 13,421.30 eurove¹⁴

8.5. B.E. mban mend se ka pasur punë vetëm me K.P.. Ai mohon të ketë autorizuar ndonjëherë një avokat për ta përfaqësuar atë në Gjykatën Komunale të Klinës. Kur iu tregua formulari i autorizimit¹⁵, B.E. deklaroi se nënshkrimi dukej si i tij, por ai ri-deklaroi se i kishin kërkuar të nënshkruante letra boshe.¹⁶

8.6. Kur iu tregua eksponati me emrin Padi, datë 28/09/2004¹⁷, B.E. deklaroi se nuk e kishte parë kurrë më parë. Gjithashtu ai mohoi ta ketë takuar ndonjëherë më parë Z.M..¹⁸

8.7. B.E. konfirmoi se në kohën përkatëse ai punonte në një qebaptore. Ai deklaroi se K.P. donte që ai të kishte një diplomë, për të ndihmuar/fryrë padinë e tij për dëmshpërblim. B.E. deklaroi se kishte siguruar një diplomë duke paguar 100 euro për të.¹⁹

8.8. Pasi iu afrua Policia lidhur me këtë padi, B.E. u ballafaqua me K.P. dhe e pyeti përse Z.M. ishte caktuar avokat i dëshmitarit pa dijeninë e tij. K.P. tentoi ta bindte dëshmitarin që të mos ballafaqohej me Z.M.. B.E. mohoi të kishte parë ose nënshkruar ndonjërin prej dokumenteve që iu treguan atij nga hetuesit e policisë. B.E. u ballafaqua edhe me Siguruesit për këtë padi, dhe i thanë se për padinë ishin paguar 72,000 euro gjithsej (d.m.th. ndërmjet të gjithë paditësve). Kur

¹⁰ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 29/01/2013, f. 15

¹¹ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 29/01/2013, f. 18

¹² Dosja e Provave I, Ndarësja 23

¹³ Dosja e Provave I, Ndarësja 11

¹⁴ Dosja e Provave I, Ndarësja 12

¹⁵ Dosja e Provave I, Ndarësja 3 dhe dorëzuar në Laboratorin Mjeko-ligjor të Kosovës si Kampioni E, me Urdhrin e datës 16/04/2013

¹⁶ Marrja në Pyetje nga Prokurori, datë 03/03/2011; Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 29/01/2013, f. 15-16

¹⁷ Dosja e Provave I, Ndarësja 2 (SHËNIM: një praktikë e përmirësuar do të caktonte një numër unik reference eksponati për çdo provë materiale në momentin fillestar të mbledhjes së eksponatit)

¹⁸ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 29/01/2013, f. 16

¹⁹ Marrja në Pyetje nga Prokurori 03/03/2011; Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 29/01/2013, f. 17

iu tregua Formulari i Shlyerjes i IIC-së i datës 03/02/2004 në emrin e B.E.²⁰, dëshmitari konfirmoi se ky ishte dokumenti që Siguruesit i kishin treguar atij, dokument që tregonte një pagesë në shumën e 15,400 eurove në favor të B.E..²¹

8.9. Kur u këshillua nga një person i paidentifikuar të hapte llogari bankare për të marrë dëmshpërblimin, dëshmitari deklaroi se K.P. reagoi keq ndaj kësaj duke i thënë *'ti nuk duhet të hapësh llogari bankare, sepse do t'i jap unë paratë, sepse ata do t'i transferojnë ato në llogarinë time bankare'*.²²

9. X.K.

9.1. Proces-verbal i Marrjes në Pyetje të Dëshmitarit/Palës së Dëmtuar, datë 23/01/2012.²³

9.2. Dëshmia e kësaj deklarate u përfshi në proces-verbal me marrëveshje ndërmjet palëve.²⁴

10. Dëshmia përkatëse e X.K. mund të përmblihet si vijon:

10.1. Më 23/08/2003, X.K. po udhëtonte në një automjet Suzuki, bashkë me B.A., X.H., N.A., dhe B.E., në autostradën XX, në vendin e quajtur XX. Shoferi e humbi kontrollin dhe automjeti u përmbys, duke u shkaktuar kështu udhëtarëve shkallë të ndryshme lëndimesh, ku X.K. pësoi lëndime të lehta trupore, dhe u nevojiti trajtim spitalor për të gjithë.

10.2. Në tetor 2003, X.K., N.A., X.H., B.A. shkuan në gjykatë në Klinikë lidhur me këtë aksident. Në Gjykatë ishin të pranishëm K.P. dhe Z.M. X.K. u pyet (megjithëse ai nuk e mban mend se nga kush) nëse ai dëshironte të padiste B.A. për lëndimet e pësuar, por X.K. nuk dëshironte ta bënte këtë dhe nënshkroi një letër për këtë qëllim, kështu besonte ai. Pas kësaj, X.K. punoi jashtë shtetit dhe nuk dëgjoi më për këtë çështje, deri në vitin 2010, kur u thirr nga një polic.

10.3. X.K. konfirmon se atij nuk iu kërkua të merrte pjesë dhe as mori pjesë në ndonjë seancë gjyqësore në Klinikë më 14 qershor 2005 dhe në asnjë fazë as ai, as ndonjë anëtar i familjes së tij që vepronte në emër të tij, nuk ka marrë ndonjë dëmshpërblim nga ndonjë lloj burimi lidhur me këtë aksident.

10.4. Për rrjedhojë, dëshmitari mohon të ketë qenë ndonjëherë në dijeni të dëmshpërblimit, apo ta ketë marrë dëmshpërblimin, siç përcaktohet në dokumentet e mëposhtme:

10.4.1. Formulari i Shlyerjes i ICC-së, referenca B-281-02-03-GD, datë 22/04/2004 për X.K. 3,550 euro²⁵

10.4.2. Aktvendimi i GJK të Klinikës, C nr 916/2004, datë 14/06/2005, që i akordon X.K. 7,177.35 euro²⁶

²⁰ Dosja e Provave I Ndarësja 23

²¹ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 29/01/2013, f. 20

²² Proces-verbal i Marrjes në Pyetje nga Prokurori, datë 03/03/2011

²³ Dosja e Provave I Ndarësja 07

²⁴ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 04/02/2013, f. 2

²⁵ Dosja e Provave I, Ndarësja 26

11. N.A.

- 11.1. Proces-verbali i Marrjes në Pyetje të Dëshmitarit/Palës së Dëmtuar, datë 22/02/2011²⁷
- 11.2. Dëshmia e kësaj deklarate u përfshi në proces-verbal me marrëveshje ndërmjet palëve.²⁸

- 12. Përshkrimi i këtij dëshmitari për aksidentin rrugor dhe udhëtarët në automjet është në përputhje me përshkrimet e mësipërme.²⁹ Ky dëshmitar pësoi lëndime të rënda trupore, që kërkuan trajtim spitalor për 4 ditë dhe më pas trajtim në shtëpi për dy muaj të tjerë.
- 13. Rreth 2 muaj më vonë, dëshmitari mori një thirrje telefonike nga K.P. i cili e pyeti nëse dëshmitari dëshironte të padiste shoferin. Dëshmitari nuk pranoi. Disa muaj më vonë, dëshmitari mori përsëri një thirrje telefonike nga një femër, e cila i deklaroi se ajo po e merrte nga Kompania e Sigurimit në Prishtinë dhe se dëshmitari duhej të shkonte tek K.P. në Gjykatën Komunale të Klinës lidhur me padinë e tij për dëmshpërblim. Dëshmitari veproi kështu dhe fillimisht K.P. i tha atij se ishte tepër vonë për të bërë ndonjë gjë. Megjithatë, K.P. i tha atij më pas të siguronte dokumentet mjekësore dhe ai do të shihte se ç'mund të bënte. Disa muaj më vonë, K.P. e kontaktoi dëshmitarin përsëri dhe e lanë që ai ta dërgonte dëshmitarin në Prishtinë. Dëshmitari bëri kështu dhe nënshkroi një letër të zbrazët. Ca kohë pas kësaj, K.P. e thirri dëshmitarin në zyrën e tij. Kur dëshmitari shkoi atje, K.P. i dha atij 1,400 euro duke i thënë *'kjo nuk mbulonte as shpenzimet e mia (të Pukës) dhe e bëra këtë vetëm sepse më treguan se ke rrethana të vështira financiare'*. Dëshmitari mohoi shprehimisht të kishte ngritur ndonjëherë padi, ta ketë udhëzuar avokatin në emër të tij, ose të ketë marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor më 14 qershor 2005 në Gjykatën Komunale të Klinës.³⁰
- 14. Për rrjedhojë, dëshmitari mohon të ketë qenë ndonjëherë në dijeni të dëmshpërblimit, ose ta ketë marrë dëmshpërblimin, siç përcaktohet në dokumentet e mëposhtme:
 - 14.1. Formulari i Shlyerjes i IIC-së, referenca B-281-04-03-GD, datë 07/06/2004, për N.A., në shumën e 11,000 eurove³¹
 - 14.2. 10.4.2. Aktvendimi i GJK të Klinës, C nr 916/2004, datë 14/06/2005, që i akordon N.A. shumën e 24,700.30 eurove³²

15. X.H.

- 15.1. Proces-verbali i Marrjes në Pyetje të Dëshmitarit/Palës së Dëmtuar, datë 22/2/2011³³
- 15.2. Dëshmia e kësaj deklarate u përfshi në proces-verbal me marrëveshje ndërmjet palëve.³⁴

²⁶ Dosja e Provave I, Ndarësja 11

²⁷ Dosja e Provave I Ndarësja 06

²⁸ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 04/02/2013, f. 2-3

²⁹ Proces-verbal i Marrjes në Pyetje të Dëshmitarit, datë 22/02/2011

³⁰ Proces-verbal i Marrjes në Pyetje, datë 22/2/2011

³¹ Dosja e Provave I, Ndarësja 25

³² Dosja e Provave I, Ndarësja 11

³³ Dosja e Provave I, Ndarësja 05

³⁴ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 04/02/2013, f. 2-3

16. Përshkrimi i dëshmitarit ishte kryesisht në përputhje me përshkrimet e dëshmitarëve lidhur me aksidentin rrugor.

17. Ky dëshmitar pësoi lëndime në kokë, gjakderdhje të brendshme si pasojë e aksidentit. Ai nuk ka marrë ndonjë dëmshpërblim lidhur me incidentin. Ai nuk ka ngritur padi, nuk ka angazhuar avokat për ta përfaqësuar, ose nuk ka marrë ndonjëherë pjesë në ndonjë seancë në Gjykatën Komunale të Klinës.

18. Për rrjedhojë, dëshmitari mohon të ketë qenë ndonjëherë në dijeni të dëmshpërblimit, apo ta ketë marrë dëmshpërblimin, siç përcaktohet në dokumentet e mëposhtme:

18.1. Formulari i Shlyerjes i IIC-së, referenca B-281-03-03-GD, datë 07/06/2004, për X.H., në shumën e 13,870 eurove³⁵

18.2. Aktvendimi i GJK të Klinës, C nr 916/2004, datë 14/06/2005, që i akordon X.H. shumën e 24,108.5 eurove³⁶

19. A.B.

19.1. Seanca e Shqyrtimit Gjyqësor, datë 30/01/2013

20. Ky dëshmitar ishte eksperti i caktuar për të llogaritur shumën e duhur të dëmshpërblimit për të katër paditësit në padinë për aksidentin. Ai konfirmoi se e kreu ekspertizën e tij bazuar në Aktvendimin e Gjykatës Komunale të Klinës, i caktuar nga K.P. Ai rishikoi e shqyrtoi dokumentet mjekësore që iu dorëzuan lidhur me secilin të paditur, për të përcaktuar masën e duhur të dëmshpërblimit. Këtij dëshmitari nuk i ishte dashur të merrte pjesë në ndonjë procedurë gjyqësore për aksidentin rrugor. Ky dëshmitar kishte shumë pak prova relevante lidhur me çështjen para trupit gjykues të shqyrtimit gjyqësor të A.R..

21. S.A.

21.1. Proces-verbali i Marrjes në Pyetje të Dëshmitares/Palës së Dëmtuar, datë 01/03/2011

21.2. Dëshmia e kësaj deklarate u përfshi në proces-verbal me marrëveshje ndërmjet palëve.³⁷

22. Dëshmitarja është përfaqësuese e Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës. Me rëndësi është fakti që dëshmia e saj është nxjerrë nga shkresat e saj në bazë të asaj që shënonin dokumentet (d.m.th. pa ditur nëse këto dokumente pasqyrojnë situatën e vërtetë apo jo). Ajo raportoi se Avokati Z.M. kishte paraqitur në Shoqatë kërkesë për dëmshpërblim. Me ndihmën e një firme nën-kontraktore të quajtur Asistenca, dëmshpërblimi i paditësve u vlerësua dhe u pagua në kuadrin e një zgjidhjeje jashtë gjyqësore, si vijon:

22.1. B.E. – 15,400 euro

³⁵ Dosja e Provave I, Ndarësja 24

³⁶ Dosja e Provave I, Ndarësja 11 dhe dorëzuar në Laboratorin Mjeko-ligjor të Kosovës si Kampioni IJ, me Urdhrin e datës 16/04/2013

³⁷ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 04/02/2013, f. 2-4

- 22.2. X.H. - 13,870 euro
- 22.3. X.K. – 3,550 euro
- 22.4. N.A. – 11,000 euro

23. Pas kësaj, Z.M. raportohet të ketë ushtruar një padi tjetër për fitimin e humbur. Për pasojë, dhe pas një seance në Gjykatën Komunale të Klinës, në të cilën i pandehuri A.R. veproi në emër të Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, gjykata shqiptoi një aktgjykim vendosës si më poshtë:

- 23.1. B.E. – 13,421.30 euro
- 23.2. X.H. – 24,108.00 euro
- 23.3. X.K. – 7,177.35 euro
- 23.4. N.A. – 24,700.30 euro
- 23.5. Bashkë me 1,850 euro shpenzime

24. Paratë u paguan më 06/09/2005 në llogarinë bankare të Z.M..

25. Z.M.

- 25.1. Kallëzim penal datë 28/12/2010 (pa dëshmi e prova në lëndë)
- 25.2. Proces-verbal i Marrjes në Pyetje si Dëshmitar/Palë e Dëmtuar, datë 04/02/2011
- 25.3. Marrja në Pyetje nga Prokurori, datë 25/03/2011 (vazhdimi i seancës së datës 4/02/2011).
- 25.4. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 30/01/2013

26. Më 28/12/2010, Z.M. paraqiti kallëzim penal në PSRK kundër K.P. dhe A.R., me pretendimin se ata kishin kryer një padi sigurimi mashtruese dhe kishin ndërmarrë një veprim gjyqësor lidhur me aksidentin rrugor të B.E., në të cilin ata kishin siguruar në mënyrë të paligjshme një shumë të konsiderueshme parash. Vetë kallëzimi përshkruan në më shumë hollësi besimin e Z.M. se si ishte kryer ky veprim mashtrues.³⁸ Përmbajtja e këtij dokumenti nuk u konsiderua nga trupi gjykues si provë në lëndë. E vetmja rëndësi e tij është vërtetimi i faktit se Z.M. është autori i ankesës penale në këtë lëndë.

27. Z.M. deklaroi se B.E. nuk e kishte nënshkruar autorizimin e tij në prani të tij. Në vend të kësaj, Z.M. e kishte marrë atë drejtpërdrejt nga K.P.³⁹ Megjithëse dëshmitari pranoi se e njohte B.E., ai mohoi të kishte dijeni për ndonjë padi për X.H., X.K. dhe N.A..⁴⁰ Në shqyrtim gjyqësor, Z.M. deklaroi se ai kishte përfaqësuar B.E. në dy seanca.⁴¹

28. Z.M. deklaroi se nuk e mbante mend nëse anëtarët e trupit gjykues kishin qenë të pranishëm në lidhje me këtë lëndë. Atij as i kujtohej nëse A.R. kishte qenë i pranishëm. Z.M. pohoi se ishte K.P. ai i cili kishte propozuar shtyrjen e seancës nga gjykata më 7/06/2005, sepse kjo ishte e nevojshme për të siguruar dëshminë e ekspertizës. Z.M. deklaroi se pas kësaj ai nuk dinte asgjë tjetër për këtë lëndë, deri afërsisht në dhjetor 2010 (d.m.th. ai nuk kishte dijeni dhe nuk kishte marrë pjesë në

³⁸ Kallëzim penal, datë 28/12/2010, Dosja e Provave I, Ndarësja 1

³⁹ Marrje në Pyetje nga Prokurori, datë 04/02/2011; Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 30/01/2013, f. 4

⁴⁰ Marrje në Pyetje nga Prokurori, datë 04/02/2011

⁴¹ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 30/01/2013, f. 3

seancën që u zhvillua më 14/06/2005).⁴² Më tej ai qartësoi se, megjithëse shkresat e Gjykatës dhe Shoqatës së Sigurimeve përmbanin dokumentin që pretendohet të jetë proces-verbali i seancës së mëtejshme, që përmban nënshkrimin e tij, Z.M. mohoi të kishte qenë i pranishëm dhe pohoi se nënshkrimi nuk ishte i tij.⁴³

29. Z.M. u vu në dijeni se lënda kishte vazhduar në mungesë të tij kur ai ishte njoftuar nga Gjykata Komunale e Klinës se Shoqata e Sigurimeve e Kosovës kishte paraqitur kallëzim penal kundër tij. Ai bëri hulumtime të thelluara në shkresat e Shoqatës së Siguruesve dhe të Gjykatës,⁴⁴ dhe vuri re se padia për dëmshpërblim ishte vendosur, me dy shuma, njëra prej rreth 13 ose 14,000 eurosh, dhe tjetra prej rreth 70,000 eurosh, dhe përfshinte 4 persona.⁴⁵ Kur u mor në pyetje, Z.M. e mohoi shprehimisht ta kishte parë ndonjëherë dëshminë e ekspertizës që ishte siguruar në atë lëndë.⁴⁶

30. Kur iu treguan një sërë dokumentesh nga Prokurori, të siguruar nga shkresat e Shoqatës së Siguruesve (që për fat të keq nuk u identifikuan nga Prokurori), Z.M. mohoi që ato nënshkrime të ishin të tijat.

31. Në shqyrtimin gjyqësor, Z.M. iu treguan dokumentet e mëposhtme:

31.1. Formulari i Autorizimit, datë 06/03/2004, që pretendon se N.A. autorizoi Z.M. për të vepruar si avokat.⁴⁷ Z.M. e mohon autenticitetin e këtij dokumenti.⁴⁸

31.2. Formulari i Autorizimit, datë ? 2004 (*data nuk duket qartë*), që pretendon se X.H. dhe X.K. autorizuan Z.M. për të vepruar si avokat.⁴⁹ Z.M. e mohon autenticitetin e këtij dokumenti.⁵⁰

31.3. Formulari i Shlyerjes i ICC-së, referenca B-281-02-03-GD, për X.K., në shumën e 3,550 eurove.⁵¹ Z.M. pohon se vula dhe nënshkrimi në këtë dokument janë të falsifikuara.⁵²

31.4. Formulari i Shlyerjes i ICC-së, referenca B-281-03-GD, datë 03/02/2004, për B.E., në shumën e 15,400 eurove.⁵³ Z.M. pohon se vula dhe nënshkrimi në këtë dokument janë të falsifikuara.⁵⁴

31.5. Formulari i Shlyerjes i IIC-së, referenca B-281-03-03-GD, datë 07/06/2004, për X.H., në shumën e 13,870 eurove.⁵⁵ Z.M. pohon se vula dhe nënshkrimi në këtë dokument janë të falsifikuara.⁵⁶

⁴² Marrje në Pyetje nga Prokurori, datë 04/02/2011; Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 30/01/2013, f. 3

⁴³ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 30/01/2013, f. 5

⁴⁴ Shih dokument në Dosjen e Provave I, Ndarësja 20 – letra e datës 22/12/2010 drejtuar GJK të Klinës, me të cilën kërkohet kopje e shkresave të lëndëve C nr. 916/2004 & C nr. 149/05

⁴⁵ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 30/01/2013, f. 3-4

⁴⁶ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 30/01/2013, f. 25

⁴⁷ Dosja e Provave I, Ndarësja 4

⁴⁸ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 30/01/2013, f. 8

⁴⁹ Dosja e Provave I, Ndarësja 5

⁵⁰ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 30/01/2013, f. 8

⁵¹ Dosja e Provave I, Ndarësja 26

⁵² Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 30/01/2013, f. 8

⁵³ Dosja e Provave I, Ndarësja 23

⁵⁴ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 30/01/2013, f. 8

⁵⁵ Dosja e Provave I, Ndarësja 24

⁵⁶ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 30/01/2013, f. 9

- 31.6. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor, C nr. 916/2004, datë 15/10/2004.⁵⁷ Në këtë dëgjim, lënda u shty për të siguruar dëshminë e ekspertizës. Z.M. e pranon nënshkrimin në dokument si të tijin.⁵⁸
- 31.7. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor, C nr. 916/2004, datë 15/03/2005.⁵⁹ Në këtë dëgjim, proces-verbali pretendon të shënojë se Z.M. ishte i pranishëm, por as përfaqësuesi për të paditurin, as eksperti nuk ishin të pranishëm. Seanca u shty. Z.M. mohon që nënshkrimi të jetë i tiji.⁶⁰
- 31.8. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor, C nr. 916/2004, datë 07/06/2005.⁶¹ Në këtë seancë, proces-verbali pretendon të shënojë se Z.M. ishte i pranishëm për paditësin, dhe A.R. ishte i pranishëm për të paditurin, dhe të 4 të paditurit ishin të pranishëm. Z.M. mohon që nënshkrimi është i tiji.⁶²
- 31.9. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor, C nr 916/2004, datë 14/06/2005.⁶³ Në këtë seancë, proces-verbali pretendon të shënojë se Z.M. ishte i pranishëm për Paditësit dhe A.R. ishte i pranishëm për të paditurin, dhe u caktua dëmshpërblimi financiar për të 4 paditësit dhe shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 71257.45 eurosh. Aktvendimi specifikonte se paratë do të paguheshin në llogarinë bankare të Z.M. në ProCredit, me numër XXXXXXXX-9000105. Z.M. mohon që nënshkrimi në këtë proces-verbal është i tiji. Më tej, megjithëse ai e pranon se e njëj B.E., ai mohon të ketë ndonjë njohuri për paditësit e tjerë.⁶⁴
- 31.10. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor, C nr. 916/2004, datë 14/06/2005.⁶⁵ Në këtë seancë (që pretendohet se është në të njëjtën datë dhe orë me proces-verbalin në paragrafin 29.4 më lart), proces-verbali pretendon të shënojë se Z.M. ishte i pranishëm për Paditësin, kurse A.R. ishte i pranishëm për të paditurin, dhe u caktua dëmshpërblimi financiar për B.E. dhe shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 15271.3 eurove. Aktvendimi specifikonte se paratë do të paguheshin në llogarinë bankare të Z.M. në ProCredit, me numër XXXXXXXX-9000105. Z.M. mohon që nënshkrimi në proces-verbal është i tiji.⁶⁶
32. Z.M. e pranon se më 05/12/2003, ai i dha K.P. qasje të autorizuar në llogarinë bankare të dëshmitarit, që dëshmitari nuk e kontrolloi asnjëherë, sepse ishte shok i K.P. dhe i besonte atij.⁶⁷ Më 10/08/2005, në llogarinë bankare të Z.M. në ProCredit, me numër XXXXXXXX-9000105, u pagua një shumë prej 71,257.45 eurosh.⁶⁸ Z.M. mohon të ketë pasur ndonjëherë dijeni se kjo shumë ishte paguar në këtë llogari.⁶⁹ Më 07/09/2005 nga kjo llogari u bënë tërheqje nga K.P..⁷⁰
33. Gjatë marrjes në pyetje të A.R. nga Z.M. si Palë e Dëmtuar, Z.M. paraqiti një proces-verbal tjetër për seancën e datës 07/06/2005 nga kopja e shkresave të lëndës të zyrës së tij. Ky proces-verbal me

⁵⁷ Dosja e Provave I, Ndarësja 8

⁵⁸ Faqja 7 e Proces-verbalit të Shqyrtimit Gjyqësor të datës 30/01/2013, Vëllimi 1, Ndarësja S

⁵⁹ Dosja e Provave, Ndarësja 9

⁶⁰ Faqja 7 e Proces-verbalit të Shqyrtimit Gjyqësor të datës 30/01/2013, Vëllimi 1 Ndarësja S

⁶¹ Dosja e Provave, Ndarësja 10

⁶² Faqja 7 e Proces-verbalit të Shqyrtimit Gjyqësor të datës 30/01/2013, Vëllimi 1 Ndarësja S

⁶³ Dosja e Provave I, Ndarësja 11

⁶⁴ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor të datës 30/01/2013, f. 7

⁶⁵ Dosja e Provave I, Ndarësja 12

⁶⁶ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor të datës 30/01/2013, f. 7

⁶⁷ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor të datës 30/01/2013, f. 11-12

⁶⁸ Dosja e Provave I, Ndarësja 13

⁶⁹ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor të datës 30/01/2013, f. 13

⁷⁰ Dosja e Provave I, Ndarësja e parë 8

rëndësi vendimtare përcakton se Proces-verbali nga shkresat e Z.M. mbajnë nënshkrimet e vërteta të Z.M. dhe A.R.. Ky proces-verbal e shtyn lëndën për një periudhë të pacaktuar, për të siguruar prova të tjera. Në proces-verbalin tjetër për të njëjtën ditë, prova e dorëshkrimit vërteton se nënshkrimi i A.R. është i vërtetë, por ai i Z.M. nuk është. Ky proces-verbal e shtyn lëndën deri më 14/06/2005 – një seancë për të cilën Z.M. deklaroi se nuk dinte asgjë dhe ku nuk kishte marrë pjesë kurrë.

34. A.R.

- 34.1. Marrja në pyetje nga Prokurori, datë 14/03/2011
- 34.2. Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 10/04/2013

35. Gjatë intervistës së tij më 14/03/2011, A.R. deklaroi se nga data 10/11/2003 deri më 01/03/2004 kishte punuar si avokat për Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës, nga data 01/03/2004 deri në datën 01/09/2004 kishte punuar si auditor i brendshëm, dhe nga data 01/09/2004 deri në datën 13/06/2005 kishte punuar si auditor i brendshëm me orar të plotë dhe përfaqësonte Shoqatën e Sigurimeve dhe Fondin e Garancisë të Kosovës, duke ndërmarrë veprime për të gjitha rastet për këto dy subjekte. Ai pohoi konkretisht se e kishte ndërprerë punësimin e tij më 13/06/2005 dhe prandaj nuk mund ta kishte përfaqësuar Shoqatën e Fondit më 14/06/2005. Kur u ballafaqua me proces-verbalin e seancës dëgjimore në Gjykatën Komunale të Klinës më 14/06/2005, A.R. përsëriti pohimin e tij se ai proces-verbal nuk mund të ishte i saktë dhe nënshkrimi nuk mund të ishte i tij, sepse ai e kishte ndërprerë punësimin e tij. A.R. pranoi se ishte caktuar për të paditurin në lëndën e B.E., dhe pohoi se kjo i kujtonte një rast të papërfunduar, kur ai e kishte lënë punën e tij.⁷¹ Siç u theksua më lart (paragrafët 31.9 dhe 31.10), për seancën e datës 14/06/2005 ka dy proces-verbale. Dëshmia e ekspertit të dorëshkrimit në fakt përcakton se nënshkrimi i A.R. në njërin proces-verbal⁷² është **sigurisht** nënshkrimi i A.R. dhe në proces-verbalin e dytë⁷³ nënshkrimi **mund** të ishte i A.R. (shih paragrafin 41.2 më poshtë). Fakti që ka siguri për një nënshkrim, duke përcaktuar se ai ishte i pranishëm dhe e nënshkroi dokumentin, do të thotë që trupi gjykues mund të bindet se çdo pasiguri se nënshkrimi 'mund' të ishte i A.R., largohet. Kjo është provë e mjaftueshme që trupi gjykues të jetë i bindur se shpjegimet e A.R. se ai nuk mori pjesë në seancë më 14/06/2005 në emër të Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës dhe Fondit të Garancisë dhe se nënshkrimet në proces-verbal nuk janë të tijat, janë thjesht të pavërteta.
36. Në shqyrtimin gjyqësor më 10/04/2011, A.R. deklaroi se kishte kontratë me Fondin e Garancisë si avokat që nga data 10/11/2003. Ai vepronte në emër të Fondit sipas kësaj kontrate, por ishte autorizuar nga Fondi në bazë rast pas rasti. Ai u autorizua të vepronte në lëndën C nr. 916/2004 (B.E.). Ky autorizim e lejonte A.R. të nënshkruante në vendimet e gjykatës.⁷⁴
37. A.R. pranoi se kishte marrë pjesë në seancën dëgjimore më 14/06/2005, e cila u mbajt në zyrën e gjyqtarit dhe jo në seancë të hapur,⁷⁵ dhe kishte nënshkruar zgjidhjen dhe vendimin në C nr. 916/2004 në shumën e 71,257.45 eurove. Duke vepruar kështu, A.R. pohoi se i kishte lexuar dhe

⁷¹ Marrje në Pyetje nga Prokurori, datë 14/03/2011

⁷² Dosja e Provave I, Ndarësja 11

⁷³ Dosja e Provave I, Ndarësja 12

⁷⁴ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 10/04/2013, f. 11

⁷⁵ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 10/04/2013, f. 21

vlerësuar të gjitha dëshmitë e provat në atë lëndë. Ai pohoi shprehimisht se Z.M. kishte qenë i pranishëm në seancën e datës 14/06/2005.⁷⁶ Z.M. mohon të ketë qenë i pranishëm (shih paragrafët 31.9 dhe 31.10 më lart) dhe dëshmia e ekspertit të dorëshkrimit përcakton se asnjë nënshkrim në ndonjë proces-verbal të datës 14/06/2005 nuk ishte, në fakt, i Z.M. (shih paragrafin 41.2 më poshtë). Kësisoj, trupi gjykues është i shtyrë të arrijë në përfundimin e qartë se, në kundërshtim me pohimet e A.R., Z.M. nuk ishte i pranishëm në atë seancë dhe Z.M. nuk nënshkroi ndonjë dokument të lëndës atë ditë.⁷⁷ Kur u pyet për zgjidhjen dhe vendimin e dytë në lëndë më 14/06/2005, në shumën e 13,421.30 eurove,⁷⁸ A.R. mohoi që nënshkrimi në proces-verbal të ishte i tiji. Ai pranoi se nuk mund të ketë dy zgjidhje dhe vendime për të njëjtën lëndë dhe, për këtë arsye, ai nënkupton se pranon se ka ndodhur një vepër penale e ndonjë lloji, por përpiket të fajësojë Z.M. për këtë vepër.⁷⁹ Lidhur me nënshkrimin që pretendohet të jetë i A.R., eksperti i dorëshkrimit deklaroi se ky nënshkrim 'mund' të ishte i A.R. (shih paragrafin 41.2 më poshtë).

38. Për sa i takon pagesës lidhur me atë lëndë në shumën e 71,257.45 eurove në llogarinë bankare të Z.M.,⁸⁰ A.R. mohoi të kishte dijeni se ishte bërë një pagesë e tillë.⁸¹
39. Lidhur me dëshmitë dhe provat e mësipërme, është e rëndësishme të theksohet se, ndërsa kur u mor në pyetje nga Prokurori më 14/03/2011 A.R. pohoi se e kishte ndërprerë punësimin në Fondin e Garancisë më 13/6/2005, në dëshminë e tij para trupit gjykues të shqyrtimit gjyqësor, A.R. pranoi se kishte qenë i punësuar në Fondin e Garancisë deri më 30/06/2005 dhe, për rrjedhojë, kishte pasur mundësi të merrte pjesë në seancën e Gjykatës Komunale të Klinës më 14/06/2005, dhe në fakt **vërtet** mori pjesë.⁸²
40. Kur u mor në pyetje nga Pala e Dëmtuar Z.M., A.R. deklaroi se Z.M. kishte qenë i pranishëm në seancën gjyqësore më 07/06/2005, sepse kishte nënshkruar proces-verbalin. Proces-verbali në shkresat e lëndës⁸³ shënon se lënda u shty për në datën 14/06/2005. Është tejet e rëndësishme të theksohet se gjatë shqyrtimit gjyqësor, u bë e qartë se Z.M. kishte në shkresat e zyrës së tij një proces-verbal të datës 07/06/2005 lidhur me lëndën. Ky dokument u sekuestrua nga Gjykata dhe iu shtua shkresave të lëndës tonë si provë. Proces-verbali i dytë për datën 07/06/2005, i gjetur në shkresat në zyrën e Z.M., shënonte se lënda ishte shtyrë për një periudhë të papërcaktuar. Eksperti gjeti se nënshkrimet që pretendohet të jenë të Z.M. dhe A.R. në proces-verbalin e dytë, ishin të vërteta. Nënshkrimi i Z.M. në proces-verbalin e parë u gjet nga eksperti se ishte **jo** i vërtetë, ndërsa nënshkrimi i A.R. në proces-verbalin e dytë u gjet se ishte i vërtetë. Prandaj është e qartë se Z.M. iu dorëzua proces-verbali që e informonte se lënda ishte shtyrë për në një datë të pacaktuar, të cilin ai e nënshkroi. Pas kësaj, u krijua një proces-verbal tjetër, që e shtynte lëndën për një javë, i cili u nënshkrua nga A.R. dhe K.P., por nënshkrimi i Z.M. ishte i falsifikuar. Në këto rrethana nuk mund të ketë përfundim tjetër përveç atij se A.R. e dinte se çfarë po ndodhte dhe kishte rënë dakord të

⁷⁶ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 10/04/2013, f. 11 dhe f. 22

⁷⁷ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 10/04/2013, f. 11 dhe f. 13

⁷⁸ Dosja e Provave I, Ndarësja 12

⁷⁹ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 10/04/2013, f. 14

⁸⁰ Dosja e Provave I, Ndarësja 13

⁸¹ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 10/04/2013, f. 15

⁸² Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 10/04/2013, f. 17

⁸³ Dosja e Provave I, Ndarësja 10 (pika H në ekspertizën e dorëshkrimit)

bashkëpunonte me K.P. për krijimin e një proces-verbali të rremë, me synimin për t'i vazhduar seancat e lëndës pa praninë e Z.M., ose, siç deklaroi Z.M., 'me të cilin unë nxirresha jashtë loje'.⁸⁴

41. Dëshmia lidhur me dorëshkrimin

41.1. Gjykata siguroi dy ekspertiza të dorëshkrimeve. E para, datë 6 mars 2013, në fakt shqyrtonte dokumentet që nuk ishin çështje në lëndë dhe mund të mos merren parasysh.

41.2. E dyta, ekspertiza e datës 05/06/2013, është tejet e rëndësishme dhe gjetjet kyçe të saj parashtrihen në tabelën më poshtë.

Dosja e Provave Referenca	Ref. e Ekspozitave në Ekspertizë	Përshkrimi i Ekspozitave	Gjetjet e Ekspertit
Ndarësja 12	C	C nr. 916/2004, Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor të datës 14/06/2005	Nënshkrimi i të paditurit (A.R.) mund të jetë i vërtetë Nënshkrimi i Z.M. është i rremë
Ndarësja 1	D	Kallëzimi penal nga Z.M. kundër K.P. dhe A.R.	Nënshkrimi i Z.M. është i vërtetë
Ndarësja 3	E	Autorizimi për Z.M. për të vepruar si avokat për B.E.	Nënshkrimi i Z.M. është i vërtetë
Ndarësja 8	F	C nr. 916/2004, Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor të datës 15/10/2004	Nënshkrimi i Z.M. është i vërtetë
Ndarësja 9	G	C nr. 916/2004, Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor të datës 15/03/2005	Nënshkrimi i Z.M. është i rremë
Ndarësja 10	H	C nr. 916/2004, Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor të datës 7/6/2005 (nga shkresat e gjykatës)	Nënshkrimi i Z.M. është i rremë Nënshkrimi i A.R. është i vërtetë
Ndarësja 11	IJ	C nr. 916/2004, Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor të datës 14/06/2005	Nënshkrimi i Z.M. është i rremë Nënshkrimi i A.R. është i vërtetë
Ndarësja 20	K	Letër e Z.M. për Kryetarin e GJK të Klinës, datë 22/12/2010	Nënshkrimi i Z.M. është i vërtetë
Ndarësja 10	L	C nr. 916/2004, Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor të datës 7/6/2005 (nga shkresat e zyrës së Z.M.)	Nënshkrimi i Z.M. është i vërtetë. Nënshkrimi i A.R. është i vërtetë

⁸⁴ Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 10/04/2013, f. 26

42. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

- 42.1. Bazuar në provat e mësipërme, trupi gjykues arrin në përfundimin e mëposhtëm;
- 42.2. Se në gusht të vitit 2003, B.E. bashkë me të tjerë pësoi lëndime në një aksident rrugor. Si pasojë e atij aksidenti, kundër Shoqatës së Siguruesve/Fondit të Garancisë për Kosovën u ngrit një padi për dëmshpërblim. Lëndës iu caktua numri C nr. 916/2004. Gjyqtar i lëndës ishte K.P.. K.P. rregulloi që Z.M. të vepronte si avokat i autorizuar në emër të B.E., kurse A.R. u autorizua të vepronte për Fondin e Garancisë, nga i cili ai u punësua më pas si avokat.
- 42.3. Më 15/10/2004, u mbajt një seancë në të cilën Z.M. propozoi sigurimin e dëshmisë së ekspertit financiar (d.m.th. të një eksperti sigurimesh). Askush nuk u paraqit në atë seancë për të paditurin. Nënshkrimi i Z.M. në Proces-verbalin e Seancës së Dëgjimit është i vërtetë.
- 42.4. Në një fazë të lëndës, padisë iu shtuan paditës të tjerë, konkretisht: X.K., X.H. dhe N.A.. Z.M. nuk kishte dijeni për këta paditës të tjerë.
- 42.5. Më 07/06/2005, në lëndë u mbajt një seancë. Z.M. mori pjesë për Paditësin B.E., kurse A.R. mori pjesë për të Paditurin. Për atë seancë ekzistojnë dy proces-verbale. Njëri prej këtyre proces-verbaleve është i rremë. Një proces-verbal u paraqit në Gjykatë nga Z.M., nga kopja e shkresave të lëndës në zyrën e tij. Ky proces-verbal e shtynte lëndën për në një datë të pacaktuar, për të siguruar prova të tjera. Si Z.M., ashtu dhe A.R. e nënshkruan atë proces-verbal. Të dy nënshkrimet janë të vërteta. Proces-verbali i dytë për të njëjtën ditë pretendon ta ketë shtyrë lëndën deri në datën 14/06/2005. Edhe nënshkrimi i A.R. në atë dokument është i vërtetë. Megjithatë, nënshkrimi i Z.M. në atë dokument është i rremë. Trupi gjykues arrin në përfundimin se proces-verbali i dytë është krijim fiktiv, i synuar për të mundësuar kryerjen e një vepre penale dhe se K.P. dhe A.R. ishin plotësisht në dijeni të këtij fakti dhe me dijeni luajtën rol aktiv në këtë sjellje.

Më 14/06/2005 u mbajt një seancë tjetër. Për të njëjtën ditë në shkresat e lëndës ekzistojnë dy proces-verbale. Gjyqtar ishte K.P.. A.R. mori pjesë në emër të Paditurit. Megjithëse proces-verbali shënon se Z.M. ishte i pranishëm, dëshmia lidhur me dorëshkrimet përcakton se nënshkrimi i Z.M. në të dy proces-verbale të është i rremë. Gjykata arrin në përfundimin se ai nuk ishte i pranishëm në atë seancë. Nënshkrimi i A.R. në proces-verbal, që u akordon shumë e përgjithshme prej 71,257.45 eurosh paditësve B.E., X.K., X.H. dhe N.A. përmes një zgjidhjeje dhe vendimi në gjykatë, është i vërtetë. Nënshkrimi i A.R. në proces-verbalin që i akordon B.E. shumë prej 13,421.30 eurosh përmes një zgjidhjeje dhe vendimi në gjykatë, 'mund' të jetë i vërtetë. Në dritën e gjetjeve të tjera për pjesëmarrjen aktive dhe me dijeni të A.R. në sjelljen e paligjshme, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk ka dyshim se edhe ky nënshkrim është i A.R.. Ky proces-verbal është i rremë, sepse në gjykatë nuk mund të ishte arritur asnjë zgjidhje, për shkak të mungesës së ndonjë përfaqësuesi për paditësin (paditësit). K.P. përdori pozitën e tij si gjyqtar për të sajuar këtë proces-verbal të rremë. Duke e bashkë-nënshkruar këtë proces-verbal, A.R. kontribuoi dukshëm në veprimet e K.P..

42.6. Si pasojë e kësaj sjelljeje, K.P. dhe A.R. në bashkëkryerje arritën të sigurojnë të paktën 71,257.45 euro, të cilat nuk kishin ligjërisht të drejtë t'i siguronin. Më 06/09/2005, këto para u paguan në një llogari bankare në emrin e Z.M.⁸⁵ Z.M. efektivisht e kishte dorëzuar kontrollin e kësaj llogarie bankare, për t'u përdorur nga K.P.. Megjithëse sjellja e Z.M. në dhënien K.P. qasje të pakontrolluar në këtë llogari bankare ishte naive, në rastin më të mirë, ai nuk është në shqyrtimin gjyqësor në këtë lëndë. Më 07/09/2005, K.P. tërhoqi nga ajo llogari bankare shumën prej 50,000 eurosh. Provat vërtet nuk përcaktojnë se çfarë ndodhi me pjesën e mbetur të shumës prej 21,257.35 eurosh. Nuk ka prova që të vërtetojnë nëse A.R. iu pagua drejtpërdrejt ose tërthorazi ndonjë shumë parash nga ky akt kriminal.

42.7. Këto fakte vërtetojnë se K.P. dhe A.R. janë të dy fajtorë për veprën e shpërdorimit të pozitës zyrtare, të kryer në bashkëkryerje. Në rastin e bashkë-kryerjes nuk është nevoja që secili kryerës të plotësojë të gjitha elementet e veprës penale. Mjafton që kryerësit t'i plotësojnë këto elemente të gjithë bashkë. Trupi gjykues arrin në përfundimin se, megjithëse vetë A.R. nuk ishte person zyrtar, siç ceket në Nenin 339, K.P. ishte. Meqë të dy luajtën rol aktiv dhe vetë vepra penale nuk mund të ishte përfunduar pa aktivitetin e të dyve, të dy ndajnë përgjegjësinë penale për veprën, sipas parimit të bashkë-kryerjes.

43. DËNIMI

43.1. I pandehuri, A.R. u akuzua me veprën e shpërdorimit të pozitës zyrtare (e kryer në bashkëkryerje me K.P.), në shkelje të Neneve 23 dhe 339 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së. Ligji penal i Kosovës ndryshoi më 01/01/2013. Neni 3.1 i KPRK (të ri) parashikon që, kur ligji ndryshon gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor, zbatohet ligji në fuqi në kohën kur u krye vepra. Megjithatë, Neni 3.2 parashikon gjithashtu se, në rast të një ndryshimi në ligj gjatë shqyrtimit gjyqësor, zbatohet ligji më i favorshëm për të pandehurin. Në këtë rast, para ndryshimit në ligj më 01/01/2013, dënimi maksimal për të pandehurin A.R. ishte tetë (8) vite burgim, siç parashikohej në Nenin 339 paragrafi 3 të KPK-së. Megjithatë, pas ndryshimit në ligj, ai iu ekspozua dënimit më të ulët maksimal prej pesë (5) vitesh burgim, siç parashikohet në Nenin 422 paragrafi 1 të KPRK (të ri). Prandaj ligji më i favorshëm është KPRK (i ri), që pasqyron veprën e mëparshme të shpërdorimit të pozitës zyrtare në Nenin 422 paragrafi 1, dhe elementin e mëparshëm të bashkëkryerjes në Nenin 31 të KPK-së.

GJYKATA THEMELORE E PEJËS

P. nr. 86/13

Sot më datë 14 qershor 2013

⁸⁵ Dosja e Provave I, Ndarësja 13

Proces-mbajtësja

Kryetari i trupit gjykues

Christine Sengl

Jonathan Welford-Carroll

Anëtari i Trupit Gjykses

Anëtari i Trupit Gjykses

Cornelie Peeck

Nushe Kuka-Mekaj

Mjet ligjor:

Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës Themelore të Pejës për Gjykatën e Apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e dorëzimit tek ta të kopjes së Aktgjykimit, sipas Nenit 398 paragrafi 1 të KPPK-së.

Shtojca A

Ekspozitat e ndodhura në Dosjen e Provave I, të dorëzuar nga Prokurori bashkë me Aktakuzën:

Nr.	Dokumenti	Data	Komente
1	Kallëzim penal	05/01/2010	
2	Padi në emrin e B.E.	28/09/2004	
3	Autorizim nga B.E.	20/09/2004	
4	Autorizim nga N.A.	06/03/2004	
5	Autorizim nga X.H. dhe X.K.	I palexueshëm	
6	Vendim i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës	13/06/2005	
7	Autorizim i Fondit të Garancive të Kosovës	04/10/2004	
8	Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor të Gjykatës Komunale të Klinës	15/10/2004	
9	Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor të Gjykatës Komunale të Klinës	15/03/2005	
10	Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor të Gjykatës Komunale të Klinës.	07/06/2005	<u>Këto janë dy proces-verbale. Dokumenti i parë në këtë Ndarëse përbëhet nga proces-verbali autentik dhe përmban nënshkrimin e vërtetë të Z.M.. Dokumenti i dytë (në mbulesë plastike) NUK është i vërtetë. Nënshkrimi i pretenduar i Z.M. nuk ishte bërë prej tij. Ky proces-verbal iu dorëzua trupit gjykues të shqyrtimit gjyqësor nga Z.M. nga shkresat e tij të lëndës gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 10/04/13.</u>
11	Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor të Gjykatës Komunale të Klinës	14/06/2005	
12	Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor të Gjykatës Komunale të Klinës	14/06/2005	
13	Deklaratë për transferimin e mjeteve në llogarinë bankare të Z.M.	10/08/2005	
14	“Diplomë” e B.E.	07/11/1997	
15	Raport i Aksidentit Rrugor më 23/08/03	23/08/2003	
16	Aktvendim për Kryerjen e Hetimeve	24/11/2003	
17	Vendim i Odës së Avokatëve të Kosovës	18/09/2003	
18	Pasqyrë nga Raiffeisen Bank për llogarinë e mbajtur nga A.R.	13/07/2005	
19	Padi nga Shoqata e Sigurimeve e Kosovës	16/12/2012	

20	Kërkesë nga Z.M. për Kryetarin e Gjykatës Komunale të Klinës	22/12/2012	
21	Formulari i Shlyerjes së Dëmshpërblimit dhe Raporti Mjekësor për B.E.	20/01/2004	
22	Formulari i Shlyerjes së Dëmshpërblimit për B.E.	20/01/2004	
23	Raport Mjekësor për B.E.	23/08/2003	
	Formulari i Shlyerjes së Dëmshpërblimit për B.E.	03/02/2004	
	Raporti i ekspertit financiar për B.E.	23/12/2004	
24	Formulari i Shlyerjes së Dëmshpërblimit për X.H.	07/06/2004	
	Formulari i Daljes nga Spitali dhe Raporti Mjekësor për X.H.	08/09/2003	
25	Formulari i Shlyerjes së Dëmshpërblimit nga Asistenca ICC për N.A.	07/06/2004	
	Formulari i Daljes nga Spitali për N.A.	Pa datë	
	Formulari i Daljes nga Spitali për N.A.	14/10/2003	
	Formulari i Shlyerjes së Dëmshpërblimit dhe Raporti Mjekësor për N.A.	Pa datë	
26	Formulari i Shlyerjes nga Asistenca ICC për X.K.	22/04/2004	
	Formulari i Shlyerjes së Dëmshpërblimit dhe Raporti Mjekësor për X.K.	14/06/2005	
27	Proces-verbal i dorëzimit të subjekteve	08/07/2005	
28	Propozim nga A.R. për ndërprerjen e hetimeve	22/03/2011	
29	Shënim për të depozituar të panëshkruarat, por pretendohet se është nga Prokurori i PSRK-së	11/03/2011	
30	Memo e Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës për PSRK	16/03/2011	
31	Proces-verbal i Intervistës me B.E.	03/03/2011	
1	Proces-verbal i Intervistës me Z.M.	04/02/2011	
2	Proces-verbal i Intervistës me S.A.	01/03/2011	
3	Proces-verbal i Intervistës me K.P.	04 & 24/08/2011	
4	Proces-verbal i Intervistës me A.R.	14/03/2011	
5	Proces-verbal i Intervistës me X.H.	22/02/2011	
6	Proces-verbal i Intervistës me N.A.	22/01/2011	
7	Proces-verbal i Intervistës me X.K.	23/01/2012	
8	Proces-verbal lidhur me llogarinë bankare të Z.M. që regjistron	28/07/2009	

	depozitimin e €71,257.41 më 06/09/2005			
9	Kampionë të lirë të nënshkrimit të A.R.t, dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 04/02/2013 dhe dërguar në Laboratorin Mjeko-ligjor të Kosovës me Urdhër të datës 16/04/2013	04/02/2013		
10	Kampionë të lirë të nënshkrimit të Z.M., dhënë Prokurorit më 11/02/2013 dhe dërguar në Laboratorin Mjeko-ligjor të Kosovës me Urdhër të datës 16/04/2013	11/02/2013		

Shtojca B

Ekspozitatet dorëzuar tek trupi gjykues i shqyrtimit gjyqësor gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor:

1	Proces-verbali i datës 07/06/2005 nga C. nr. 916/2004		Dorëzuar nga Z.M. nga shkresat e lëndës gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 10/04/2013.	Ky proces-verbal u ekzaminua nga Laboratori Mjeko-ligjor i Kosovës ("LMK"). Nënshkrimi i pretenduar i Z.M. NUK është i vërtetë.
2	Raport i Grafologut, z. H.K., datë 22/02/2013		Dorëzuar nga Pala e Dëmtuar, Z.M. gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 10/04/2013.	

Shtojca C

Ekspozitat e nxjerra me Urdhër të kryetarit të trupit gjykues gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor:

1	Shkresat e lëndës në C. nr. 149/2005		Të marra nga Gjykata Komunale e Klinës, me Urdhër të kryetarit të trupit gjykues, datë 07/02/2013	
2	Raport nga KFL, datë 06/03/2013.		I përpiluar në bazë të Urdhrit të kryetarit të trupit gjykues, datë 07/02/13.	Ky raport u përqendrua në faktorë jo relevantë dhe në fund u përdor pak ose aspak nga trupi gjykues i shqyrtimit gjyqësor.
3	Raport nga KFL, datë 05/06/13		I përpiluar në bazë të Urdhrit të kryetarit të trupit gjykues, datë 16/04/13.	